



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës

Vendos: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendimi i Gjashtë mbi Heqjen e Redaktimeve ose Zbatimin e Redaktimeve të
Reja në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre**

me Shtojcën 1 konfidenciale

T'i njoftohet:

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon vendimin e gjashtë mbi heqjen e redaktimeve apo zbatimin e redaktimeve të reja në transkriptet e seancave gjyqësore dhe riklasifikimin e tyre.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 maj 2023, Trupi Gjykues urdhëroi palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të ndërmarrin në vijimësi rishikimin e transkripteve pas përfundimit të çdo blloku dëshmish dhe të paraqesin parashtrime në një parashtrim përmbledhës nëse mund të hiqen redaktimet ekzistuese dhe/ose të riklasifikohen transkriptet si publike, me qëllim respektimin e parimit të gjykimit publik, duke mbajtur masën mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat.¹

2. Më 12 qershor 2023, Trupi Gjykues urdhëroi Zyrën Administrative, sidomos Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD), të lidhej me palët dhe Mbrojtësin e Viktimave dhe, nëse dëshironin, të shtonin propozimet e tyre për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve, parashtrimeve të përbashkëta të palëve dhe të Mbrojtësit të Viktimave.²

3. Nga 20 deri në 29 nëntor 2023, gjatë bllokut të nëntë të dëshmive, Trupi Gjykues dëgjoi dëshmitë e Zijadin Hoxhës (W03887), Safete Hadërgjonajt (W04441), Time Kadrijajt (W04440), dëshmitarit ekspert Andre de Villiers Horne

¹KSC-BC-2020-04, F00510, Trupi Gjykues I, Urdhri i Dytë për Parashtrime në lidhje me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore, 15 maj 2023, publik, para. 5, 8.

² KSC-BC-2020-04, F00541, Trupi Gjykues I, Vendim mbi Heqjen e Redaktimeve apo Zbatimin e Redaktimeve të Reja në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre, 12 qershor 2023, publik, para. 25, me Shtojcën 1, konfidenciale.

(DW4-03) dhe të dëshmitarit W04280.³ Gjithashtu, më 9-10 janar 2024, gjatë bllokut të dhjetë të dëshmive, Trupi Gjykses dëgjoi dëshminë e Safet Gashit (W04405).⁴

4. Më 13 dhjetor 2023 dhe 24 janar 2024, palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja paraqitën propozimet e tyre të përbashkëta lidhur me zbatimin e redaktimeve të reja dhe/ose riklasifikimin e transkripteve të seancave gjyqësore që u mbajtën nga 20 deri më 29 nëntor 2023 (Propozimi i Parë i Përbashkët)⁵ dhe më 9-10 janar 2024 (Propozimi i Dytë i Përbashkët).⁶

II. PARASHTRIMET

5. Palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja propozojnë riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seanca private më 20-24 dhe 28-29 nëntor 2023 dhe më 9 janar 2024, duke bërë redaktime, sipas nevojës, me qëllim mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave dhe të informacionit konfidencial lidhur me ta.⁷ Nuk janë paraqitur propozime për seancat gjyqësore të mbajtura më 27 nëntor 2023 dhe 10 janar 2024.

³ Transkripti i seancës, 20 nëntor 2023, konfidencial, f. 3164-3283; Transkripti i seancës, 21 nëntor 2023, konfidencial, f. 3284-3407; Transkripti i seancës, 22 Nëntor 2023, konfidencial, f. 3408-3518; Transkripti i seancës, 23 nëntor 2023, konfidencial, f. 3519-3611; Transkripti i seancës, 24 nëntor 2023, konfidencial, f. 3612-3627; Transkripti i seancës, 27 nëntor 2023, konfidencial, f. 3628-3727; Transkripti i seancës, 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3728-3829; Transkripti i seancës, 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3830-3884. Trupi Gjykses vëren se W04280 përfiton nga masat mbrojtëse ndaj publikut. *Shih gjithashtu* Transkripti i seancës, 28 nëntor 2023, konfidencial, faqja 3732, rreshti 2 deri në faqen 3733, rreshti 6.

⁴ Transkripti i seancës, 9 janar 2024, konfidencial, f. 3885-3999; Transkripti i seancës, 10 janar 2024, konfidencial, f. 4000-4076.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00747, Mbrojtja, *Parashtrim i Mbrojtjes lidhur me Propozimin e Përbashkët për Heqjen e Redaktimeve në Bllokun e Nëntë të Dëshmive*, 13 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00785, Mbrojtja, *Parashtrim i Mbrojtjes lidhur me Propozimin e Përbashkët për Heqjen e Redaktimeve në Bllokun e Dhjetë të Dëshmive*, 24 janar 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁷ Shtojca 1 e Propozimit të Parë të Përbashkët, f. 2-7; Shtojca 1 e Propozimit të Dytë të Përbashkët, f. 2.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykses vë në dukje nenet 21(2), 23, 40(2), (4) dhe (6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 80, 84(1) dhe 120 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

IV. ANALIZË

7. Trupi Gjykses kujton se, në bazë të nenit 21(2) të Ligjit, dhe në varësi të çdo mase mbrojtëse të urdhëruar sipas nenit 23 të Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, i akuzuari ka të drejtë për seancë publike kur vendoset për akuzat kundër tij. Me qëllim respektimin e parimit të gjykimit publik, duke mbajtur masat mbrojtëse të marra, Trupi Gjykses ka ushtruar detyrën e tij sipas rregullës 84(1) të Rregullores për rishikimin e klasifikimit të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura nga 20 dhe 29 nëntor 2023 dhe më 9-10 janar 2024 dhe, sipas rastit, urdhëron riklasifikimin e tyre, sikundër përcaktohet më poshtë. Për lehtësi referimi, Trupi Gjykses rendit të gjitha riklasifikimet dhe redaktimet që duhen bërë nga Zyra Administrative në transkriptet përkatëse në një shtojcë bashkëngjitur këtij vendimi.

8. Trupi Gjykses vëren se palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja pajtohen se disa fragmente të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seanca private më 20-24 dhe 28-29 nëntor 2023 dhe më 9 janar 2024 mund të bëhen publike, duke iu nënshtruar redaktimeve.⁸

⁸ Shtojca 1 e Propozimit të Parë të Përbashkët, f. 2-7; Shtojca 1 e Propozimit të Dytë të Përbashkët, f. 2.

9. Trupi Gjykses konstaton se propozimet e palëve, Mbrojtësit të Viktimave dhe ZMMD-së përputhen me qasjen e Trupi Gjykses për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit dhe vendosin ekuilibrin e duhur midis të drejtave dhe interesave të ndryshëm në diskutim, konkretisht, parimit të gjykimit publik sipas nenit 40(4) të Ligjit, të drejtës së të akuzuarit për seanca publike sipas nenit 21(2) të Ligjit, dhe mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit. Megjithatë, Trupi Gjykses e vlerëson të nevojshme të zbatojë redaktime shtesë në fragmentet e transkripteve që palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja kërkojnë të riklasifikojnë si publike, për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe informacionin konfidencial lidhur me ta. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton kërkesat e Propozimeve të Para dhe të Dytë të Përbashkëta për riklasifikimin si publik të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të lartpërmendura, në varësi të redaktimeve të kërkuara dhe udhëzimeve të Trupit Gjykses, sikurse përcaktohen në shtojcën e këtij vendimi.

10. Përveç propozimeve të palëve, Mbrojtësit të Viktimave dhe ZMMD-së, Trupi Gjykses mendon se fragmente të tjera të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura më 20, 22 dhe 27-29 nëntor 2023 mund të riklasifikohen si publike, duke bërë redaktime, për ta bërë plotësisht të zbatueshëm parimin e gjykimit publik, duke siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, të viktimave dhe informacionin konfidencial të lidhur me ta.

11. Mbështetur në sa më sipër, Trupi Gjykses autorizon riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të lartpërmendura të mbajtura në seanca private dhe zbatimin më pas të redaktimeve në to, në përputhje me shtojcën e këtij vendimi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike pjesë të transkripteve të seancave private, në pajtim me

udhëzimet e përfshira në shtojcën e këtij vendimi, me kusht që t'u nënshtrohen zbatimit të redaktimeve në to. Riklasifikimi i lartpërmendur i transkripteve zbatohet njëllor në transkriptet në gjuhën shqipe dhe serbishte.

12. Së fundi, Trupi Gjykses përfshin përmes referimit udhëzimet e tij të mëparshme për Zyrën Administrative në lidhje me zbatimin e redaktimeve në materialin në audio dhe video të transkripteve përkatëse të seancave gjyqsore.⁹

V. VENDIM

13. Për arsyet e sipër përmendura, Trupi Gjykses:

- a) **AUTORIZON** riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqsore të mbajtura në seanca private dhe zbatimin më pas të redaktimeve në të, në pajtim me paragrafin 11 të këtij vendimi;
- b) **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike pjesë të transkripteve të seancave gjyqsore, në të gjitha gjuhët, me redakte, sikundër përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi;
- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të zbatojë, sa të jetë e mundur teknikisht, redaktimet në materialin përkatës në audio dhe video të transkripteve përkatëse të seancave gjyqsore, në të gjitha gjuhët; dhe
- d) **UDHËZON** Njësinë e Administrimit të Gjykatës të kontaktojë Trupin Gjykses nëse lind ndonjë problem në zbatimin e këtij vendimi.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00579, Trupi Gjykses I, *Urdhri i Dytë për Parashtrime lidhur me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqsore*, 11 korrik 2023, publik, para. 24-25, me Shtojcën 1, konfidenciale.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E mërkurë, 7 shkurt 2024

Në Hagë, Holandë.